

# Operacioni “Qielli i thyer” vazhdoi edhe sot në bashkëpunim ndërkombëtar- kontrollohen 25 lokacione e arrestohen 7 persona



24/09/2025 15:10

f

Prokuroria Speciale e Kosovës është deklaruar në lidhje me aksionin e gjerë policor që është zhvilluar në kuadër të hetimeve nga operacioni i njohur “Qielli i thyer”.

Prokuroria njoftoi se aksioni i koduar “Qielli i thyer” është realizuar në 25 lokacione të ndryshme, ku si rezultat janë arrestuar shtatë persona të dyshuar për përfshirje në vepra penale si: pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar; blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve; si dhe pastrimi i parave, raporton [lajmi.net](#).

Të pandehurit, dyshohet se kanë përdorur aplikacionin e njohur për komunikim të enkriptuar “SkyECC” për të organizuar aktivitetet e tyre kriminale.




Gjatë realizimit të urdhër kontrollit në këto lokacione është gjetur dhe sekuestruar sasi e konsiderueshme e provave materiale, dhe pasurive të specifikuara duke përfshirë:

- 638 gramë substancë narkotike e dyshuar si kokainë;
- Një ( 1 ) peshore për matjen e lëndëve narkotike;
- 11,065 euro para të gatshme;
- 34 automjete;
- Shtatë (7) armë zjarri;
- Dokumente personale me identitet të rremë;
- Pajisje elektronike;
- Dokumentacion i ndryshëm pronësor dhe financiar.

Operacioni është mbështetur nga një bashkëpunim i ngushtë ndërkombëtar, përmes shkëmbimit të të dhënave me autoritetet belge, franceze, holandeze dhe agjencinë europiane Europol, duke siguruar koordinim të plotë ndërkufitar.

Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës mbesin të përkushtuara në luftimin e krimit të organizuar, duke synuar jo vetëm parandalimin, por edhe sjelljen para drejtësisë të atyre që cenojnë ligjin dhe rendin./[Lajmi.net/](#)



## Artikuj të ngjashëm



September 24, 2025  
**Saliu reagon pas incidentit në Komunën e Prishtinës: Nuk kam sulmuar...**



September 24, 2025  
**Kurti viziton për ngushëllime familjen e Enver Petrovcit: I kishte të...**

## LAJME TË FUNDIT



Saliu reagon pas incidentit në Komunën e Prishtinës...



Kurti viziton për ngushëllime familjen e Enver Petrovcit...



Kryediplomati italian kërkon "riunifikimin e Ballkanit Perëndimor me...



Revista ku ofendohej UÇK-ja, Basha: Është hequr emri...